

# STATUSI I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

## HOTEL TEMALI 2 SHPK

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### NENI 1

##### EMERTIMI

Sot me date 15/02/2024 në bazë të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Q.K.R” të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” me vullnetin e lirë ortaket Z. Zef Guri dhe Z. Nikoll Guri themelojnë shoqërinë **HOTEL TEMALI 2 SHPK**

Shoqëria e ka seline Velipoje Pulaj, Lagjia Plazh, Rruga Nr. 5, Nr Pasurie 801, Zone Kadastrale 3072 dhe njihet me emrin **HOTEL TEMALI 2 SHPK**

Shoqëria **HOTEL TEMALI 2 SHPK** ka të drejtë të celë filial degë e përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë e jashtë saj, në përputhje me legjislacionin Shqiptar e ato të vendeve të tjera ku ato do të hapen.

Z. Zef Guri është administrator I shoqërisë për një afat 5 vjeccar.

#### NENI 2

Shoqëria **HOTEL TEMALI 2 SHPK** zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozita të parashikuara në dokumentet e krijimit të saj (statutit). Shoqëria **HOTEL TEMALI 2 SHPK** shpk është person juridik.

#### NENI 3

Shoqëria **HOTEL TEMALI 2 SHPK** krijohet për të ushtruar veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje mbi 10 vjet.

Shoqëria **HOTEL TEMALI 2 SHPK** mund të zgjatë afatin e veprimtarisë së saj ose mund ta mbyllë aktivitetin e saj para këtij afati, sipas dispozitave që përcaktohen në këtë statut dhe sipas kritereve që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi.

#### NENI 4

Shoqëria **HOTEL TEMALI 2 SHPK** për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit me të tretët, përgjigjet vetëm me pasurinë e saj. Ortakët e shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasurinë e tyre që nuk është futur në kapitalin e shoqërisë. Pjesëmarrja me këtë shoqëri

nuk pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie.

## NENI 5

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria **HOTEL TEMALI 2 SHPK** do të ketë si objekt: HOTEL

## KREU II

### MARRËDHËNIET EKONOMIKE-FINANCIARE

## NENI 6

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar I shoqërisë **HOTEL TEMALI 2 SHPK** është 100,000 lekë I ndarë në dy kuota:

Ky kapital zoterohet nga Zef Guri me 50% te kapitalit të Shoqërisë me vlere nominale 50.000 lekë dhe Nikoll Guri me 50% te kapitalit të shoqërisë me vlere 50.000 leke.

Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij e janë të transferueshme si ndërmjet nga ortakëve ashtu edhe përkundrejt personave të tretë.

Transferimi I kapitalit ose pjesëve të tyre në favor të një personi të tretë bëhet gjithmonë me miratim të ortakëvet dhe me akt noterial.

Në qoftë se njëri nga ortakët dëshiron të shesë kuotat e kapitalit të tij, duhet të respektojë të drejtën e parablerjes nga ortakët e tjerë, ose aprovimin e tyre unanim për shitjen e pjesës së tij e një subjekti tjetër.

Vlerësimi I kapitalit themeltar në natyrë bëhet nga ortakët në një marrëveshje të vecantë ose një nga ekspertët kompetentë I caktuar nga ortakët.

## NENI 7

Zmadhimi ose zvogëlimi I kapitalit themeltar bëhet me vendimas amblesë së ortakëve. Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen në një rregjistër të veccantë.

## NENI 8

Fitimet neto I realizuar nga aktiviteti I shoqërisë do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me kuotat e tyre takuese në kapitalin themeltar.

#### NENI 9

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancin e saj. Bilanci I aktivitetit të shoqërisë përgatitet në fund të vitit e duhet të dorëzohet Brenda muajit mars të vitit që vijon.

Bilanci I aktivitetit financiar mund të bëhet nga vetë ortakët ose nga ekspertët e tyre. Por në të gjitha rastet, rezultatet e bilancit financiar duhet ti bëhen të aprovohen nga Asambleja e ortakëve Brenda muajve të mbylljes së vitit financiar.

#### NENI 10

Shoqëria krijon fondet e saj për zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit.

Rezervat statuore te jene ne masen 5 % te fitimit.

Përbërja e fondeve, burimet financiare të tyre, caktohen nga asambleja e ortakëve.

#### NENI 11

Shoqëria i disponon plotësisht mjetet e saj financiare.

### KREU II

#### TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

#### NENI 12

Ortakët kanë të drejta kryesore të cilat ushtrohen nëpërmjet vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve.

Të marrin pjesë ne administrimin e veprimtarive ekonomike-tregtare të shoqërisë, në përputhje me kontratën dhe statusin.

- Të kërkojnë dhe tu jepen të dhëna që kanë të bëjnë me gjendjen dhe veprimtarinë e shoqërisë si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara nga shoqëria (bilanci, libra llogarie).
- Të bëjnë propozime dhe t’I paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblesë së Shoqërisë.

- Të heqin dorë nga shoqëria në kushtet që përcaktohen në kontratë dhe në këtë statut.

#### NENI 13

Ortakët kanë këto detyra kryesore:

- Të depozitojnë kuotën e tyre ose kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe me vendimet e Asamblesë (për fondin rezervë).
- Të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga ata vetë.
- Të respektojnë detyrimet e caktuara nga Asambleja ose nga Administratori për realizimin e detyrave të shoqërisë.

#### KREU IV

### ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË

#### NENI 14

Organi më i lartë vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

Në asamble marrin pjesë të gjithë ortakët me të drejtë vote sipas shumave të vëna në kapitalin themeltar të shoqërisë. Asambleja e ortakëve kryen këto funksione:

- Miraton Bilancin vjetor të shoqërisë.
- Vendos për shtimin, pakësimin ose transferimin e kapitalit themelor.
- Emëron dhe revokon Administratorin e shoqërisë.
- Emëron dhe revokon Ekspertin kontabël të Shoqërisë.
- Kryen modifikime në statusin pas ecurive të shoqërisë si dhe kontroll të shoqërisë.
- Vendos për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë ose shndërrimin e saj me një tip tjetër shoqërie.

#### NENI 15

Administratori I shoqërisë përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët dhe ka të gjitha kompetencat për të vepruar në e më dhe për llogaritë e shoqërisë.

Shoqëria merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që mund të vijë nga veprimet e kryera nga administratori. Administratori Z. Zef Guri ka afat maksimal 5-vjet dhe afati është I detyrueshëm të parashikohet në aktet e shoqërisë.

#### NENI 16

Administrator është përgjegjësi individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose ndaj personave të tretë, kur gjatë veprimeve të tyre shkelin ligjin, kontratën dhe statutin, si dhe shkeljet e kryera nga ai gjatë administrimit të shoqërisë. Marrëdhëniet e punës me punëtorët që do të punësohen pranë

shoqërisë **HOTEL TEMALI 2 SHPK** rregullohen me kontrata individuale, që do të lidhen me secilin prej tyre

**KREU V**

**MBYLLJA E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË**

**NENI 17**

Veprimtaria e shoqërisë pushon me mbarimin e afatit të përcaktuar në kontratë në qoftë se ortakët me vullnetin e tyre të lirë nuk zgjatin këtë afat.

Shoqëria mund ti japë fund aktivitetit të saj dhe para afatit të përcaktuar në aktin e themelimit, me aprovimin e Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 18**

Kur shoqëria likujdohet plotësisht, Asambleja krijon komisionin e likujdimit në të cilin paraqet bilancin e likujdimit.

Pasuria e shoqërisë, pasi shlyhen detyrimet e shoqërisë, do të ndahet mes ortakëve në proporcion me kontributin e tyre në kapitalin themeltar.

Pasuria që është futur në shoqëri me të drejtë shfrytëzimi I kthehet pronarëve të saj.

**Ortakët e Shoqërise**

**Zef Guri**



**Nikoll Guri**

